

VENDIM
Nr. 425, datë 26.6.2024

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE MËSIMORË DHE TË PUNONJËSVE TË TJERË JOMËSIMORË NË
INSTITUCIONET ARSIMORE DHE NË INSTITUCIONET PLOTËSUESE TË
SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR
(Ndryshuar me VKM nr. 127, datë 27.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të neneve 37, pika 5, e 59, pika 3, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit mësimorë (mësues/edukatorë, instruktorë), punonjësit e shërbimit psiko-social, si dhe punonjësit e tjerë jomësimorë, që shërbejnë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar në:

- a) arsimin parashkollor;
- b) arsimin fillor;
- c) arsimin e mesëm të ulët;
- ç) arsimin e mesëm të lartë;
- d) institucionet arsimore për përkujdesjen për kategori të veçanta të nxënësve;
- dh) qendrat kulturore të fëmijëve;
- e) konviktet e nxënësve.

2. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore të punonjësve, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, janë, si më poshtë vijon:

- a) Për punonjësit mësimorë:
 - i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune;
 - ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome përcaktohet në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - iii. shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën:
 - 0.6 (zero pikë gjashtë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - 1 (një) % pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - iv. shtesa për kategorinë e kualifikimit, që shpërblen zhvillimin profesional të punonjësve mësimorë përgjatë karrierës së tyre, pas përfitimit të kategorisë së kualifikimit, do të llogaritet në përqindje, për çdo kategori, si më poshtë vijon:
 - 10 (dhjetë) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë “mësues i kualifikuar”;
 - 20 (njëzet) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë “mësues specialist”;
 - 30 (tridhjetë) % të shtesës së nivelit të kualifikimit, për kategorinë “mësues mjeshtrë”.

Masa në përqindje, sipas përcaktimeve të mësipërme, llogaritet mbi vlerën e përcaktuar në lidhjen nr. 4, të këtij vendimi, për grupin përkatës të diplomës, referuar nivelit më të lartë të kualifikimit, që zotëron punonjësi mësimor;

v. shtesa për natyrë të veçantë pune e aplikueshme për disa pozicione në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional.

b) Për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe punonjësit e tjerë jomësimitorë:

i. paga për pozicion, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni pune;

ii. shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome përcaktohet në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

iii. shtesa për vjetërsi në punë, që jepet në masën:

- 0.6 (zero pikë gjashtë) % pas çdo viti pune, për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

- 0.8 (zero pikë tetë) % pas çdo viti pune, për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

- 1 (një) % pas çdo viti pune, për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vjet) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

4. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për punonjësit mësimitorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe për punonjësit e sigurisë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës për punonjësit mësimitorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “a”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Shtesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit, të cilët ushtrojnë detyrën në pozicionet “mësues i teorisë/dhe ose praktikës profesionale” dhe “instruktur i praktikës profesionale” në shkollat e arsimit të mesëm të lartë profesional është në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

8. Punonjësit mësimitorë efektivë, që, për nevoja të procesit mësimitor, japin orë mësimi mbi normën e lejuar mësimore, për çdo orë mësimore shtesë paguhet në masën:

a) në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, 390 (treqind e nëntëdhjetë) lekë/për orë;

b) në shkollat e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, 300 (treqind) lekë/për orë.

9. Punonjësit e jashtëm të specialiteteve të ndryshme, që japin mësim në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, si dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve, që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimitorë), për çdo orë mësimore paguhet në të njëjtën masë me punonjësit mësimitorë efektivë, sipas përcaktimeve në pikën 8, të këtij vendimi.

10. Mësuesit dhe instruktorët me kohë të pjesshme, që japin mësim në ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, të cilët punësohen me kontratë të përkohshme pune në bazë të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, paguhet në masën 600 (gjashtëqind) lekë për çdo orë mësimore.

11. Punonjësit mësimitorë, të cilët punojnë larg vendbanimit, përfitojnë një kompensim në masën, si më poshtë vijon:

a) kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, mbi 5 (pesë) kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës dhe kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 2 700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj;

b) kur punojnë brenda rrethit të tyre, jashtë qendrës urbane, mbi 5 (pesë) kilometra larg vendbanimit/qendrës së punës, por nuk kthehen brenda ditës në vendbanimin e tyre, masa e kompensimit është 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

Në të dyja rastet, kompensimi për largësi nga vendbanimi nuk aplikohet për periudhën gjatë së cilës punonjësi mësimor kryen pushimet vjetore të pagueshme.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara, si dhe nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

13. Vendimi nr. 175, datë 8.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij vendimi
(Zëvendësuar me VKM nr. 127, datë 27.2.2026)

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës; Drejtor në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Drejtor në institucionet e arsimit special; Drejtor i shkollës në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, dhe shkollat me status të veçantë.	1	107,120
2	Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës; Zëvendësdrejtor i shkollës së arsimit të mesëm të lartë, me mbi 700 nxënës;	1	105,070

	Zëvendësdrejtore në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Zëvendësdrejtore në institucionet e arsimit special; Zëvendësdrejtore i shkollës, në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, dhe shkollat me status të veçantë; Përgjegjës i bazës prodhuese.		
3	Drejtore i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës; Zëvendësdrejtore i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me 301 deri në 700 nxënës; Drejtore i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës.	1	102,000
4	Zëvendësdrejtore i shkollës së arsimit të mesëm të lartë me deri në 300 nxënës; Drejtore i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës.	1	99,950
5	Drejtore i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës.	1	98,950
6	Drejtore i shkollës fillore klasa I–IV; Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive; Zëvendësdrejtore i shkollës 9-vjeçare.	1	96,350
7	Mësues koordinator për sigurimin e cilësisë dhe këshillimin e karrierës në shkollat e arsimit të mesëm të lartë dhe arsimit të mesëm të ulët.	1	77,000
8	Mësues në shkollat e arsimit të mesëm të lartë; Mësues në institucionet e arsimit special; Mësues/specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta, në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Mësues/specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv dhe shkollat me status të veçantë; Mësues i teorisë dhe/ose praktikës profesionale.	1	76,000
9	Specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta, në Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë/Institutin e Nxënësve	2 ose 3,	76,000

	që nuk Shikojnë/qendrat burimore; Specialistë/ekspertë të programeve specifike të veçanta në institucionet e arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv dhe shkollat me status të veçantë.	ose 4	
10	Mësues në arsimin e mesëm të ulët në shkollat 9-vjeçare.	1	74,000
11	Mësues në arsimin fillor në shkollat 9-vjeçare; Instruktor i praktikës profesionale.	1 ose 2, ose 3, ose 4.	73,000

Shënim. Kriteret për miratimin e “Mësues koordinator” për sigurimin e cilësisë dhe zhvillimin e karrierës, dhe numri i tyre për institucionet arsimore përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

Lidhja nr. 2

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit e shërbimit psiko-social dhe për punonjësit e sigurisë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi
(Zëvendësuar me VKM nr. 127, datë 27.2.2026)

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Punonjës psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar	1	73,000
2	Oficer i sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar	1	63,000

Lidhja nr. 3

Vlerat e elementit “pagë për pozicion” dhe grupi i diplomës, për punonjësit mësimorë në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të përcaktuara në shkronjat “a”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij vendimi

(Zëvendësuar me VKM nr. 127, datë 27.2.2026)

Nr.	Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit
1	Drejtor konvikti	1	104,040
2	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	102,000
3	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	82,000
4	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	77,000
5	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	76,000
6	Instruktur në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	63,000
7	Edukator konvikti; Kujdestar konvikti.	1 ose 2, ose 3 ose 4	61,000
8	Edukator në kopsht fëmijësh	1 ose 2, ose 3 ose 4	61,000

Lidhja nr. 4

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit për çdo grup diplome

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lekë/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-së (Master i Shkencave. Master i Arteve; Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike; Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14,000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master Profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12,000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10,000
4	“Diplomë e maturës shtetërore”, të shkollës së mesme pedagogjike, për të cilat jepet titulli “Mësues i shkollës fillore”. “Diplomë e maturës shtetërore”, të shkollës së mesme profesionale, për të	8,000

	cilat fitohet specialiteti për mësuesi. Diplomë e maturës shtetërore të shkollave me drejtim të orientuar. Diplomë mbi shkollën e mesme. Të tilla konsiderohen të gjitha diplomat e kurseve me program mësimor të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomat jouniversitare profesionale dyvjeçare. Diplomë e shkollës së mesme profesionale.	
--	--	--